



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.587/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi –Kryetar, z. Blerim Dina –Referues, z. Goran Milenkovic –Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: N.SH “Clean”, – Ferizaj, kundër njoftimit për dhënien e Kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: N.N.P “Blinaja-A.M”- Gllanasellë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e objekteve Komunale të Komunës së Gjakovës”, me numër të prokurimit: 632-20-1271-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK-Gjakovë” më datën: 25.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik: N.SH “Clean”, – Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e objekteve Komunale të Komunës së Gjakovës”, me numër të prokurimit: 632-20-1271-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK-Gjakovë”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e objekteve Komunale të Komunës së Gjakovës”, me numër të prokurimit: 632-20-1271-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK-Gjakovë” dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që kon formë dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik: N.SH “Clean”, – Ferizaj, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që kon formë nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: N.SH "Clean", – Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 24.08.2020 me nr. 587/20, kundër njoftimit për dhënien e Kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e objekteve Komunale të Komunës së Gjakovës", me numër të prokurimit: 632-20-1271-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ "KK-Gjakovë" duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 8, 16, 17, 28, 29, 59, si dhe Nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. si dhe /RRUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datës: 08.09.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimor: Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit ku OE ankues thotë që AK i ka eliminuar pa të drejtë me arsyetimin se lideri nuk ka ofruar dëshmi – referenca në vlerë prej 130,000 euro punë të përfunduara gjatë 3 viteve të fundit, Eksperti Shqyrtues pas rishikimit të dokumentacionit e gjen pretendimin si të bazuar dhe jep këtë mendim:

Konform dispozitave ligjore, periudha e vlefshmërisë e kontratave si referencë merret duke pasur parasysh datën e përfundimit të kontratës. Një gjë e tillë mund të shihet edhe në RRUOPP, tek pjesa e "Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):", gjegjësisht pjesa: "Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: ".....të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara "ose "...në periudhën e shkuar trevjeçare...". Në kuptimin e Ligjit shprehja "tri vitet e shkuara" nënkupton: Periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprin datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim"

Një interpretim është dhënë decitivisht edhe nga KRPP, duke theksuar që “nëse gjatë një aktiviteti të prokurimit, një Autoritet Kontraktues në dosje të tenderit ka vendosur kërkesën që Operatorët Ekonomik të kenë kontrata të realizuara në 3 vitet e fundit (nga data e njoftimit për kontratë), kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë, ku për bazë merret data e përfundimit dhe jo e fillimit të kontratës”. Një interpretim i tillë është ri-konfirmuar nga Eksperti Shqyrtues në bashkëbisedim edhe me zyrtarët e KRPP-së në një takim sqarues.

Një interpretim dhe konstatim i tillë është dhënë edhe në raportin e ekspertizës, respektivisht vendimin e panelit të OSHP-së me numër 376-385/20 (shih pjesën e vendimit nga paneli i OSHP-së lidhur me këtë pretendim më poshtë), ku në listën e kontratave, gjegjësisht referencave të bashkëngjitura të OE ankues, kontrata me MPB-në e mbulon kriterin e përcaktuar nga AK.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE NSH “Clean”, ku ky i OE ankohet në dy pretendime.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK na ka eliminuar neve me arsyetimin se lideri nuk ka ofruar dëshmi –referenca në vlerë 130.000.00 euro punë të përfunduar gjatë 3 viteve të fundit , por kjo fare nuk qëndron nga qe ne si lideri kemi prezantuar listën e kontratave dhe referencave ku në total kemi ofruar dëshmi për 3 referenca ku vlera financiare e tyre kap shumën 378.602,29 euro , ku vetëm referenca e lëshuar nga MPB në shumë 130.804,29 mbulon kriterin e parapare nga AK , andaj vlerësojmë se pretendimi i AK është komplet i pa baze dhe në kundërshtim me LPP Kërkesa në FDT është: shih *Fakti 3- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2*

Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues konstaton ky pretendim është i bazuar për faktin se konform dispozitave ligjore, periudha e vlefshmërisë së kontratave si referencë merret duke pasur parasysh datën e përfundimit të kontratës. Një gjë e tillë mund të shihet edhe në RRUOPP, tek pjesa e “Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se)”, gjegjësisht pjesa: “Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: “.....të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara “ose “...në periudhën e shkuar trevjeçare...”). Në kuptimin e Ligjit shprehja “tri vitet e shkuara” nënkupton: Periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprin datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim”

Shih më lartë tek faktet e rëndësishme (te dhëna në raportin e ekspertizës):

Fakti 4- Kontrata “Shërbime të pastrimit të objekteve të MPB-së” 01.08.2016-31.07.2017

Fakti 5- Lista e Kontratave (vetëm kontrata me MBP e mbulon këtë kriter, gjerësa dy kontratat e tjera janë mbi periudhën tri vjeçare)

Lidhur me pretenimin e ankuesit se AK si shkelje të detytë ka bërë kur ka shpallur fitues kompaninë Selmans Network Sh.p.k. i cili ka ofruar çmimin e njëjtë si ne, por që e ka dorëzuar ofertën pas dorëzimit të ofertës sonë.

Sa i përket pretendimit ku OE ankues thotë që AK ka shpallur operatorin ekonomik NNP Blinaja – AM pa të drejtë fitues pasi që ky i fundit ka ofertuar me çmim total prej 79,603.44 EUR apo në baza mujore 6,633.62 EUR duke mos llogaritur kështu pagën e Menaxherit si dhe as materialin që do të shpenzohet gjatë ekzekutimit të projektit, Eksperti pas shqyrtimit të dokumentacionit jep këtë mendim:

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues e paraqitur në “Tabelën me specifika dhe sasinë në baza mujore për secilin produkt dhe për secilin objekt përkatës të Komunës së Gjakovës” sa i përket punëtorëve të kërkuar për angazhim figuron totalin prej 17 punëtorësh. Me një pagë të caktuar bruto prej 310 eurosh, shpenzimet minimalisht të pranura sa i përket kostos së pagave për 12 muaj janë këto:

Paga Bruto	5% I punedhenesit	Paga total	TVSH (18%)	Pagat - mujore (17 punetore)	Pagat - vjetore (17 punetore)
€	€	€	€	€	€
310	15.50	325.50	384.09	6,529.53	78,354.36

Pas pyetjes së Ekspertit Shqyrtues drejtuar Autoritetit Kontraktues si më poshtë:



Dior Halili

Mon 9/7/2020 11:11 AM

Sent Items

Mark as unread

To: ☐ Faton Gutaj;

Pershendetje,

Shpresoj qe jeni mire me shendet. Une jam Dior Halili, Ekspert Shqyrtues ne OSHP I caktuar per lenden me nr. te prokurimit: 632-20-1271-2-2-1 iniciuar nga Ju.

Per faktin qe ankesa e OE ankues ka te beje me pretendimet ankimore te natyres se llogaritjes se cmimit total, kerkoj te me sqaroni si ne vijim:

- Kerkese ne FDT, gjegjesisht tek pjesa e Specifikacioneve Teknike, pika 19 eshte “Kompania duhet të ofrojë një menaxher për mbikqyrjen e punës”, ndersa tek “Tabela me specifika dhe sasinë në baza mujore për secilin produkt dhe për secilin objekt përkatës të Komunës së Gjakovës” jane listuar vetem 17 punetore duke mos perfshire menaxherin perkunder kerkeses se lartpermendur.
- Si rezultat, a eshte dashur te oftohet me 18 punetore apo me 17 punetore nga operatoret ekonomik?
- Nese eshte dashur me 17, cila eshte arsyeja e angazhimit te menaxherit, dhe ne cfare menyre eshte menduar ajo?

Faleminderit,

Eksperti ka marrë këtë përgjigje:



Faton Gutaj

Tue 9/8/2020 11:57 AM

Mark as unread

To: ☐ Dior Halili;

I/E nderuar,

Operatori ekonomik është dashur të oftoj me 17 punëtorë, sepse është menduar që OE fituese duhet të ketë një menaxher të vetin, të cilin e paguan vet, i cili mbykqyer, menaxhon dhe i organizon punëtorët gjatë kryerjes së shërbimeve. Është menduar që ky të jetë si njëfarëloj përfaqësues i kompanisë i cili vepron në emër të saj në raport me punëtorët dhe i cili do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me menaxherin tone të kontratës.

Me respekt
Zyra e prokurim

Eksperti vlerëson që AK ka lënë shumë paqartësi sa i përket llogaritjes së pagave të punëtorëve se çka mund të llogaritet, po ashtu është krijuar hapësirë e manipulimit nga OE me paga të punëtorëve pasi që kërkesat në specifikacionet teknike në të shkruar apo në tabelë me ato të vendosura në paramasë (sado gjysmake që është ajo) kanë krijuar diskrepancë në llogaritje të njësisë matëse. Konform dispozitave ligjore të RRUOPP, gjegjësisht pikave 20.3 dhe 20.4, specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca

Paramasa nuk paraqet një dekompozim të mirëfilltë të pikave duke mos iu referuar konkretisht se në cilën pikë nevojiten pozitat e përmendura në tabelën e paraqitur në pjesën e specifikimeve. Si e tillë, është në mospërputhje me kërkesat e dosjes. Po ashtu, çmimi për njësi i caktuar si “m2” nuk është i arritshëm të merret si mesatare duke marrë parasysh njësitë e tjera matëse të vendosura në tabelën e lartpërmendur, respektivisht, kalkulimin e orëve të punës në variante të ndryshme dhe numrin e punëtorëve jo të specifikuar mirë.

Për faktin që kriteret e përlllogaritjes nuk përputhen me përshkrimin e çmimeve, dhe ekziston një diskrepancë sa i përket logjikës së llogaritjes së çmimit njësi si çmim mesatar total dhe si të dekompozuar nga Operatorët Ekonomik, korrigjimet në dosjen e tenderit nuk janë të mjaftueshme për sqarim dhe për të krijuar uniformitet në mënyrën e llogaritjes, gjegjësisht vlerësimit nga Autoriteti Kontraktues që rezulton nga mos detajimi i mirëfilltë i dosjes dhe kriterëve të saj matëse.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë, natyrën e pretendimeve dhe pamundësinë e korrigjimit të dosjes pas hapjes së tenderit, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e objekteve Komunale të Komunës së Gjakovës” me nr. të prokurimit: “632-20-1271-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Gjakovë, të anulohet dhe nëse Autoriteti Kontraktues ka nevojë të ri tenderohet konform nenit 105 të LPP-së, gjegjësisht paragrafit 2.8. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve, duke marrë parasysh gjendjen faktike të aktivitetit të prokurimit sa i përket përgatitjes jo adekuate të dosjes së tenderit nga AK.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë pjesërisht e bazuar dhe të anulohet aktiviteti i prokurimit në fjalë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 08.09.2020 me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik, me datë: 09.09.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit profesional.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.09.2020, pa praninë e palëve kon formë nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të e ekspertit profesional, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës

Lidhur me pretendimin e ankuesit se AK i ka eliminuar pa të drejtë me arsyetimin se lideri nuk ka ofruar dëshmi – referenca në vlerë prej 130,000 euro punë të përfunduara gjatë 3 viteve te fundit.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratës ka kërkuar operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat te natyrës se ngjashme ne tre vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te nga data e publikimit te njoftimit për kontrate. Ne një vlere jo me pak se 130.000.00€, ne rast konsorciumi lideri duhet te ketë te paktën 60% kontratat te natyrës se ngjashme.

Duke pas parasysh faktin se AK ka eliminuar OE ankues me arsyetimin se Njoftimi për kontrate për aktivitetin prokurimit ne fjale është bere me dte:08.04.2020, qe i bie se referencat e juaja duhet te jen nga data 08.04.2017,20182019,2020.Dy nga referencat e juaja janë para kësaj date(16.03.2015,15.03.2017 dhe 16.03.2027)qe i bie se vetëm një reference është valide ajo e datës 01.08.2016-31.07.2017 vlere e te cilës është 130.804.29€(ku valide janë vetëm katër muaj 4,5,6 dhe 7 d.m.th 130,904.29:12muaj =10,900.36x4 muaj =43,601.44€.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se konform dispozitave ligjore, periudha e vlefshmërisë e kontratave si referencë merret duke pasur parasysh datën e përfundimit të kontratës. Një gjë e tillë mund të shihet edhe në RRUOPP, tek pjesa e “Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):”, gjegjësisht pjesa: “Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 te LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: “.....të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara “ose “...në

periudhën e shkuar trevjeçare...”). Në kuptimin e Ligjit shprehja “tri vitet e shkua” nënkupton: Periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprin datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim”

Një interpretim është dhënë dëgjuesisht edhe nga KRPP, duke theksuar që “nëse gjatë një aktiviteti të prokurimit, një Autoritet Kontraktues në dosje të tenderit ka vendosur kërkesën që Operatorët Ekonomik të kenë kontrata të realizuara në 3 vitet e fundit (nga data e njoftimit për kontratë), kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkua nga data e njoftimit për kontratë, ku për bazë merret data e përfundimit dhe jo e fillimit të kontratës”. Një interpretim i tillë është ri-konfirmuar nga Eksperti Shqyrtues në bashkëbisedim edhe me zyrtarët e KRPP-së në një takim sqarues. Andaj paneli shqyrtues konstaton se pretendimi i ankuesit në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm nga fakti se AK ka mundur të kërkojë sqarime nga ana e petatorit ekonomik dhe të vërtetojë se dëshmitë e ofruara janë në pajtim me dispozitat dhe interpretimet e cekura si më lart.

Paneli shqyrtues vjen në konstatimin se AK me rastin e rivlerësimit të kërkojë sqarime nga ana e OE ankues në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së, në mënyrë që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në bazë të kriterëve dhe kërkesave të dosjes së tenderit, dispozitave ligjore dhe interpretimit të cekur si më lart.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se AK e ka shpallur operatorin ekonomik NNP Blinaja – AM pa të drejtë fitues pasi që ky i fundit ka ofertuar me çmim total prej 79,603.44 EUR apo në baza mujore 6,633.62 EUR duke mos llogaritur kështu pagën e Menaxherit si dhe as materialin që do të shpenzohet gjatë ekzekutimit të projektit.

Paneli shqyrtues konstaton se eksperti shqyrtues i është drejtuar autoriteti kontraktues me email zyrtarë duke kërkuar sqarimet si më poshtë :

Pyetja e së Ekspertit Shqyrtues drejtuar Autoritetit Kontraktues është si më poshtë:



Dior Halili

Mon 9/7/2020 11:11 AM

Sent Items

Mark as unread

To: ☐ Faton Gutaj;

Pershendetje,

Shpresoj që jeni mirë me shendet. Une jam Dior Halili, Ekspert Shqyrtues ne OSHP i caktuar per lenden me nr. te prokurimit: 632-20-1271-2-2-1 iniciuar nga Ju.

Per faktin qe ankesa e OE ankues ka te beje me pretendimet ankimore te natyres se llogaritjes se cmimit total, kerkoj te me sqaroni si ne vijim:

- Kerkese ne FDT, gjegjesisht tek pjesa e Specifikacioneve Teknike, pika 19 eshte “Kompania duhet të ofrojë një menaxher për mbikqyrjen e punës”, ndersa tek “Tabela me specifika dhe sasinë në baza mujore për secilin produkt dhe për secilin objekt përkatës të Komunës së Gjakovës” jane listuar vetem 17 punetore duke mos perfshire menaxherin perkunder kerkeses se lartpermendur.
- Si rezultat, a eshte dashur te ofertohej me 18 punetore apo me 17 punetore nga operatoret ekonomik?
- Nese eshte dashur me 17, cila eshte arsyeja e angazhimit te menaxherit, dhe ne cfare menyre eshte menduar ajo?

Faleminderit,

Eksperti ka marrë këtë përgjigje:



Faton Gutaj
Tue 9/8/2020 11:57 AM

Mark as unread

To: ☐ Dior Halili;

I/E nderuar,

Operatori ekonomik është dashur të ofertoj me 17 punëtorë, sepse është menduar që OE fituese duhet të ketë një menaxher të vetin, të cilin e paguan vet, i cili mbykqyer, menaxhon dhe i organizon punëtorët gjatë kryerjes së shërbimeve. Është menduar që ky të jetë si njëfarëloj përfaqësues i kompanisë i cili vepron në emër të saj në raport me punëtorët dhe i cili do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me menaxherin tone të kontratës.

Me respekt
Zyra e prokurim

Andaj duke u bazuar në sqarimet e dhëna si me lart paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues e ka sqaruar se për piken e cekur si me lart operatoret ekonomik është dashur të ofertojnë me 17 punëtor , dhe vlerësimi i ofertave të operatoreve ekonomik pjesëmarrës është bërë në baze të kësaj logjike dhe përshkrimi .

Paneli shqyrtues konstaton se e pajtim me nenin 108/A të LPP-së dhe piken (a) të paragrafit 1 të nenit 4 të *Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave* , për kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në kundërshtim me LPP-në, si dhe përgatitjen e dosjes së tenderit nga ana e AK-së në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së, operatoreve ekonomik ju është lejuar kërkesa për rishqyrtim - ankesa në fazën e njoftimit për kontratë dhe atë pesë (5) ditë para hapjes së ofertave në AK me pas edhe në OSHP.

Nëse operatoret ekonomik nuk parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim – ankesë në këtë fazë lidhur me përgatitjen e dosjes së tenderit, kriteret dhe specifikacionet e kërkuara në atë dosje nga ana e AK-së, kjo nënkupton se operatoret ekonomik e kanë pasur të qartë dosjen e tenderit, kriteret dhe specifikacionet teknike të kërkuara për atë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 72 i LPP-së.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit sipas sqarimeve që i janë dhënë edhe ekspertit shqyrtues dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues kon formë nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KK-Gjakovë;

1x1 OE- N.SH "Clean", – Ferizaj;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.